



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



NSHT "Digit"  
Ulpiana A/IV  
Prishtinë

Vendimi LIC/CO-CIMC: 2008/09  
Ref: 0805/0717/CIMC/II

## **VENDIM**

*lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllorë NSHT "Digit"- Roganë dhe Janjevë*

---

### **Fakte**

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 02/L-15 ka nxjerr Rregulloren e Distribimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC 2007/04) e cila ka hyrë në fuqi më datë 06 korrik 2007.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregulloreve CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllorë kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Operatori kabllor NSHT "Digit", si operator kabllor aktiv i cili operon në Roganë dhe Janjevë, ka aplikuar për licencë të KPM-së për operator kabllor më 15 prill 2008.

## **Arsyetim**

4. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor NSHT "Digit" ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.
5. Me Rregulloren për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor, prandaj Këshilli i KPM-së vlerëson se një operator kabllor mund të licençohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
6. Operatori kabllorë NSHT "Digit" do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
7. Nëse pas marrjes së licencës, operatori kabllor NSHT "Digit" siguron marrëveshje shpesh/të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve për të cilat e ka licencuar. Operatori kabllor NSHT "Digit" obligohet t'i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t'i ketë siguruar ato
8. KPM vlerëson se NSHT "Digit" ka paraqitur aplikacionin brenda afatit të përcaktuar nga ana e Këshillit të KPM-së në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04.
9. Prandaj, KPM vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor NSHT "Digit" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

## **Vendim**

10. KPM konkludon se NSHT "Digit" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në Roganë dhe Janjevë.
11. KPM vendos që operatorit kabllor NSHT "Digit", i cili operon në Roganë dhe Janjevë, t'i lëshoj licencën e KPM-së për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kabllore për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
12. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor NSHT "Digit" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.

13. Në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC Nr. 2007/4, çdo operator kabllor duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencim të Operatorëve Kabllorë është i përcaktuar me Nenin 3.1 të Vendimit për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Takës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve përmes Kabllos (CIMC 2007/05).
14. Në pajtueshmëri me Nenin 6.2 të Vendimit (CIMC 2007/05), operatori kabllor NSHT "Digit" duhet ta paguaj taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të Licencës.

### Lëshimi i Vendimit

15. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.

A. Guri  
Argjentina Grazhdani  
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.

29/05/08  
datë

### Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

N. Krasniqi  
Nafte Selimaj Krasniqi  
Shefe Ekzekutive



29.05.08  
datë